

Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore të Kosovës (REGIP)

Termet e Referencës për

Specialist i GIS-it për të mbështetur Projektin e Sistemit të Adresave (5 pozita)

Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 14.60 milion EUR për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP).

Komponenti C: *Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore*. Qëllimi i këtij komponenti është të mbështesë zbatimin e Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit të AKK-së dhe Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës të cilat janë zhvilluar në kuadër të projektit të Kadastrit dhe Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (RECAP) Të dy dokumentet e strategjisë tregojnë vizionin për: (a) thjeshtimin e mëtejshëm të proceseve të punës, (b) rritjen e standardizimit të informacionit dhe qasjen në informacion që do të përmirësonte efikasitetin e stafit dhe zyrave, (c) rritjen e transparencës dhe llogaridhënies; (d) qasjen e barabartë në informacion; (e) ngritjen e përdorimit të informacionit dhe shërbimeve gjeohapësinore për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja; dhe (f) minimizimin e mundësive për praktika korruptive.

Një nga aktivitetet kryesore në kuadër të Komponentit C është kompletimi i Sistemit të Adresave në Kosovë. Aktiviteti përfshin kompletimin e caktimit të adresave të ndërtesave, sinjalizimin e emrave të rrugëve dhe numrave të shtëpive dhe regjistrimin e të dhënave përkatëse në Regjistrin Qendror të Adresave (ARIS). Aktiviteti do të zbatohet në një përpjekje të përbashkët nga AKK-ja dhe Komunitat.

Komunitat, të monitoruara nga AKK, do të jenë përgjegjëse të përgjithshme për përfundimin e projektit të Sistemit të Adresave dhe do të kryejnë menaxhimin e përgjithshëm të projektit.

Për realizimin e Projektit të Kompletimit të Adresave, Njësia e Adresave në AKK duhet të forcohet me 5 Specialistë të GIS-it, të cilët do të caktohen për të mbështetur aktivitetet për Projektin e Sistemit të Adresave.

NjIP është në kërkim të pesë (5) Specialistëve të GIS-it me orar të plotë për të ndihmuar NjIP/AKK-në në çështjet e Regjistrimit të Adresave në kuadër të projektit REGIP.

Objektivi i përgjithshëm:

Objektivi i përgjithshëm është të mbështesë krijimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e një sistemi të adresave në Kosovë duke mbështetur AKK-në dhe komunat në Kosovë dhe duke siguruar qëndrueshmëri në nivel qendror dhe komunal për një periudhë afatgjatë, bazuar në Ligjin për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimet Administrative.

Specialistët do të jenë përgjegjës për mbështetjen e AKK-së dhe komunave në kompletimin e sistemit të adresave në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht për mbështetjen e AKK-së dhe ARC-së në ndërlidhjen e qytetarëve me adresat. Specialistët do të punojnë ngushtë me stafin përgjegjës të caktuar të AKK-së dhe komunave për të kryer digjitalizimin e të dhënave të adresave, mirëmbajtjen, sigurimin e cilësisë/kontrollin (SC/KC) të të dhënave të adresave, duke përfshirë rrugët, pikat e adresave, numërimin e pikave të adresave, tabelat e adresave, pikat e referencës, veçanërisht lidhjen e qytetarëve me adresat.

Rezultatet që duhet të arrihen nga Specialistët e GIS-it:

- Rezultati 1: SC/SC raporton për procesin e lidhjes së Sistemit të Adresave me Sistemin e Gjendjes Civile.
- Rezultati 2: SC/SC raporton për prodhimin dhe instalimin e tabelave me emrat e rrugëve dhe numrat e adresave, duke monitoruar procesin.

Detyrat specifike të Specialistit të GIS janë:

- Bashkëpunimi, asistimi, mbështetja dhe këshillimi i Njësisë së Adresave të AKK-së dhe komunave në implementimin e sistemit të adresave;
- SC/KC i të dhënave të adresave të mbledhura në terren nga kontraktori i angazhuar;
- Vlerësimi i cilësisë së të dhënave (plotësia, saktësia, qëndrueshmëria, vlefshmëria dhe integriteti) i të dhënave të marra nga palët e treta deri në kompletimin e sistemit të adresave
- Asistimi i komunave në digjitalizimin e të dhënave të adresave në Sistemin Informativ të Regjistrimit të Adresave (ARIS) të mbledhura në terren nga kontraktori në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimet Administrative dhe metodologjinë e aplikueshme;
- Mbështetja e AKK-së dhe komunave me digjitalizim dhe analizë hapësinore;
- Përgatitja e një harte me tabelat e rrugëve për secilën komunë në format digjital dhe mbështetja e AKK-së dhe komunave për printimin e hartave të kërkuara;
- Monitorimi i procesit të prodhimit dhe instalimit të tabelave me emrat e rrugëve dhe numrat e adresave në terren;
- Monitorimi i procesit të ndërlidhjes së Sistemit të Adresave me Sistemin e Gjendjes Civile;

- Dorëzimi i letrave informuese për adresat në terren për qytetarët;
- Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme për ndërtimin e kapaciteteve profesionale;
- Raportimi te Drejtori i Drejtorisë për Kadastrë/Gjeoinformacion dhe përgjigja ndaj kërkesave ad-hoc nga AKK/Njësia e Adresave për informacione shtesë;
- Çdo detyrë tjetër të kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, Drejtori i Drejtorisë për Kadastrë/Gjeoinformacion të AKK-së dhe Koordinatorin i NjIP-it.

Specialist i GIS-it

Kualifikimet, njohuritë dhe përvoja e kërkuar

- Diplomë universitare në gjeografi, gjeodezi ose fusha të ngjashme;
- Minimumi 2 vite përvojë pune në përdorimin e sistemeve të informacionit gjeografik.
- Përvoja e punës në Sistemin Informativ të Regjistrimit të Adresave do të ishte një avantazh i shtuar;
- Njohuri dhe përvojë me softuerin e GIS-it për desktop (GeoMedia, ArcGIS, QGIS, apo të ngjashme);
- Njohuritë dhe përvoja në WebGIS do të ishte një avantazh i shtuar;
- Kërkohen aftësi të shkëlqyera në Microsoft Word, Excel dhe Power Point;
- Njohuritë, aftësitë dhe përvoja në projekte të financuara nga organizata ndërkombëtare do të jenë një avantazh i shtuar;

Kompetencat dhe aftësitë e kërkuara

- Aftësi për të komunikuar dhe shkruar raporte në gjuhën angleze dhe shqipe. Njohja e gjuhës serbe do të ishte një avantazh;
- Të jetë i organizuar mirë dhe i aftë për të mësuar shpejt sistemet dhe procedurat komplekse;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe efektive në mjedis ekipor;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrje minimale dhe vëmendje të kujdesshme ndaj detajeve;
- Aftësi për të marrë iniciativë, për të caktuar prioritetet dhe për të koordinuar punën, për të përballuar presionin në arritjen e afateve strikte dhe orar të gjatë.;
- Aftësi për të punuar në një mjedis pune të shumëllojshëm multietnik dhe multikulturor;

Periudha e performancës

Specialisti GIS-it do të punojë me orar të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të jetë deri në fund të projektit në gusht të vitit 2025. Kohëzgjatja e kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme të rënë dakord gjatë vlerësimit zyrtar të planifikuar në fund të çdo viti. Pagesa do të

kryhet në bazë të tarifës mujore të rënë dakord në kontratë. Konsulenti pritet të fillojë shërbimet me nënshkrimin e kontratës.

Raportimi

Specialisti GIS do t'i raportojë Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër/Gjeoinformacion të AKK-së dhe do të dorëzojë raportin mujor të vijueshmërisë në punë për të llogaritur ditët aktuale të punës gjatë muajit kalendarik.

Procesi i përzgjedhjes

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në përzgjedhjen e konsulentëve individual përmes një thirrjeje të hapur.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit, dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale dhe pa diskriminim në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose ndonjë kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.